

LISTA PËRJASHTUESE

Nuk duhet të krijohet apo mbahet marrëdhënie pune me klientët e përkufizuar si grupe të personave juridik të lidhur që janë të përfshirë në një prej aktiviteteve më poshtë:

Praktikat joetike dhe kushtet e punës:

1. Prodhimi ose aktivitetet që përfshijnë forma të dëmshme ose shfrytëzuese të punës të detyruar/punës të dëshme të fëmijëve¹, praktikat diskriminuese, ose praktikat që parandalojnë të punësuarit të ushtrojnë në mënyrë të ligjshme të drejtat e tyre të asociimit dhe marrëveshjet kolektive;
2. Prodhimi ose tregtimi i narkotikëve²;
3. Prodhimi ose tregtimi i armëve (duke përfshirë armët e gjuetisë) dhe municionet³;
4. Lojërat e fatit (duke përfshirë lojërat e fatit në internet), kazinot dhe ndërmarrjet ekuivalente⁴;
5. Lëshimi i kriptomonedhave ose operimi i platformave të këmbimit të kriptomonedhave;
6. Prostitucioni apo çfarëdo pune, aktiviteti parësor i së cilës lidhet me pornografi;
7. Klinikat e riprodhimit dhe institucionet tjera mjekësore të përfshira në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jo të drejtëpërdrejtë në surrogaci⁵ (psh. Përmes ndërmjetësimit apo sistemeve tjera të lehtësimit) apo trajtime tjera mjekësore të dyshimta nga aspekti etik, duke përfshirë modifikimin dhe manipulimin e materialit gjenetik ose terapia për zëvendësimin mitokondrial⁶ dhe praktikat e komodifikimit të organeve njerëzore

Aktivitetet e dëmshme për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin jetësor:

8. Prodhimi ose tregtimi i fibrave të palidhura të azbestit ose produkteve që pëmbajnë azbest⁷;
9. Prodhimi ose tregtimi i produkteve që pëmbajnë bifenile të poliklorinuara⁸;
10. Prodhimi ose tregtimi i produkteve farmaceutike, pesticideve/herbicideve dhe substancave tjera të rrezikshme që i nënshtrohen përjashtimeve ose ndalimeve ndërkombëtare⁹;
11. Prodhimi ose tregtimi i materialeve radioaktive (duke përfshirë ruajtjen dhe trajtimin e mbetjeve radioaktive) punë dhe aktivitete që lidhen me industrinë nukleare ose materialet nukleare¹⁰;

¹ Këtu përfshihet çdo aktivitet që lidhet me trafikimin e qënieve njerëzore. Puna e detyruar do të thotë të gjithë punët ose shërbimet, të cilat nuk janë realizuar në mënyrë vullnetare, që realizohen nga një individ nën kërcënimin e forcës ose ndëshkimit. Puna e dëmshme e fëmijëve do të thotë punësimi i fëmijëve që paraqet shrytëzim ekonomik, apo ka gjasa që të jetë i rrezikshëm, ose të ndërhyjë në arsimin e fëmijëve, ose të jetë i dëmshëm për shëndetin e fëmijëve, apo zhvillimin fizik, shpirtëror, moral ose social. Për udhëzime të mëtejshme ju lutemi referoheni: IFC (shihni Deklaratën për politika të përbashkëta të IFC/MIGA për punën e detyruar dhe punën e dëmshme të fëmijëve); Deklarata e ILO mbi Parimet dhe të drejtat themelore në punë, dhe parimet e parashikuara në këto konventa: Konventat 29 dhe 105 të ILO (puna e detyruar dhe skllavëruese), 87 (liria e asociimit), 98 (e drejta për marrëveshje kolektive), 100 dhe 111 (diskriminimi); 138 (rroga minimale); 182 (format më të këqija të punës të fëmijës); Deklata Universale e të Drejtave të Njeriut.

² Nocioni "narkotike" i referohet të gjithë drogave narkotike dhe substancave psikotrope të rradhitura nga Konventa e vetme e KB mbi drogat narkotike (1961) si dhe Lista e verdhë e Bordit Ndërkombëtar për Kontrollin e Narkotikëve (INCB). Çdo aktivitet që lidhet me prodhimin dhe tregtimin e këtyre drogave narkotike është përjashtuar, përveç për qëllime mjekësore apo shkencore në pajtim me dispozitat e përkufizuara nga Konventa e vetme e Kombeve të Bashkuara mbi drogat narkotike (1961).

³ Përjashtohen nga kjo dispozitë kompanitë e sigurimit të cilat blejnë armë të vogla dhe municione për përdorim personal dhe që nuk kanë për qëllim rishitjen e tyre.

⁴ Kjo dispozitë përjashton llotaritë e organizatave bamirëse të cilat investojnë ekskluzivisht të ardhurat e tyre në aktivitete bamirëse për përfitime të përgjithshme si dhe ato persona ose subjekte që fitojnë më pak se 25% nga qarkullimi i tyre duke ofruar lojëra të fatit.

⁵ Në rast se një grua (nëna surrogate) pranohet që të lind një fëmijë për një person apo persona që do të bëhet(n) prind(ër) të fëmijës pas lindjes. Grupi ProCredit zbaton Kodin Civil Gjerman, pjesën 1591, sipas të cilit nënë e fëmijës është gruaja që ka lindur atë.

⁶ Një formë e veçantë e fekondimit in vitro në të cilën një pjesë ose e gjithë ADN-ja mitokondriale e foshnjës së ardhshme vjen nga një palë e tretë dhe mund të përfshijë transferimin e boshitit të nënës (MST), transferimin pronuklear (PNT) dhe transferimin e trupit polar (PBT).

⁷ Kjo nuk vlen për blerjen dhe përdorimin e shtresave të çimentos të lidhura me azbest ku përmbajtja e azbestit është <20%.

⁸ Bifenilet e poliklorinuara: grupi i kimikateve që janë shumë toksike që mund të gjenden në transformatorët elektrik të mbushur me naftë, nga kondensatorët dhe pajisjet shpërndarëse që datojnë nga periudha 1950-1985.

⁹ Një listë e produkteve që i nënshtrohen përjashtimit ose ndalimit është në dispozicion nga IFC ose BERZH. Dokumentet e referencës përfshijnë Rregulloren e BE (EEC) Nr. 2455/92 në lidhje me eksportin dhe importin e kimikateve të caktuara të rrezikshme, të ndryshuara; Lista e konsoliduar e KB për produkte konsumi dhe ose/shitja e të cilave është ndaluar, tërëqëhur, është kufizuar rreptësisht ose nuk është miratuar nga Qeveritë; Konventa mbi procedurat e pëlqimit të informuar paraprak për disa kimikate dhe pesticide të rrezikshme në tregtinë ndërkombëtare (Konventa e Roterdamit); Konventa e Stokholmit për ndotësit organik të qëndrueshëm; Klasifikimi i OBSH për pesticide sipas rezikut.

12. Peshkimi i paqëndrueshëm¹¹;
13. Dërgesa e naftës apo substancave tjera të rrezikshme në cisterna të cilat nuk përputhen me kërkesat e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO)¹²;
14. Aktivite që përfshijnë çlirimin e organizmave të modifikuara gjenetiki në mjedisin natyror pa miratimin e dhënë nga institucionet kompetente ose kur institucioni përkatës ka deklaruar se nuk përmban OMGJ¹³;
15. Tregtia e kafshëve të egra ose produkteve të kafshëve të egra të rregulluara me CITES¹⁴;
16. Funksionimi i aktiviteteve të gjuetisë¹⁵;
17. Lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të ndaluara me të drejtën ndërkombëtare¹⁶;
18. Çdo lloj hidrocentrali me kapacitet prodhues më të madh se 15 MW dhe hidrocentrale magazinuese me diga të mëdha¹⁷;
19. Prodhimi ose tregtimi i substancave që shkatërrojnë ozonin që i nënshtrohen përjashtimit ndërkombëtar¹⁸;
20. Prerja e paqëndrueshme¹⁹;
21. Shfrytëzimi i minierave të diamanteve dhe komercializimi i diamanteve, kur shteti pritës nuk ka aderuar në Marrëveshjen Kimberli (KPCS) apo marrëveshjet tjera të ngjajshme ndërkombëtare mbi burimet nxjerrëse;
22. Gërmimi nëntokësor për nxjerrjen e metaleve, qymyrit, argjilës të naftës dhe mineraleve tjera;
23. Prodhimi i qymyrit me metoda të ndryshme nga metoda e replikimit (përdorimi i kontejnerëve metalik të mbyllur)

Aktivitetet që kanë ndikim negativ në komunitet:

24. Prodhimi ose tregtimi i çdo produkti ose aktiviteti që konsiderohet i kundërligjshëm sipas ligjeve ose rregullave të shtetit pritës (dmth korniza ligjore nacionale) ose konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, duke përfshirë, pa kufizim, legjisllacionin ose konventat që lidhen me mbrojtjen e resurseve të biodiversitetit²⁰ ose trashëgiminë kulturore;

¹⁰ Kjo nuk vlen për blerjen e pajisjeve mjekësore, pajisjeve për kontrollin (matjen) e cilësisë dhe çdo pajisje tjetër kur burimi radioaktiv është i parëndësishëm dhe/ose i mbrojtur në mënyrë përkatëse..

¹¹ Kjo ka të bëjë me peshkimin e paligjshëm, të paraportuar ose parregulluar (IUU), peshkimin e specieve të varfëruara dhe peshkimin me rrjeta të lëvizshme në mjedisin detar duke përdorur rrjeta që janë më të gjata se 2.5 km.

¹² Kjo përfshin: cisternat të cilat nuk kanë certifikatat e kërkuara MARPOL, SOLAS (duke përfshirë, pa kufizim, pajtueshmërinë me Kodin e ISM) cisternat që janë në listë të zeze nga Bashkimi Evropian ose janë ndaluar nga Memorandumi për mirëkuptim i Parisit mbi kontrollin shtetëror të porteve (MM i Parisit) dhe cisternat e përjashtuara për shkak të rregullës 13G dhe 13H të Aneksit I të MARPOL. Nuk duhet të përdoret mbi 25 vjet asnjë pjesë e strukturës të cisternës.

¹³ Për shtetet ku funksionon BERZH: aktivitetet që përfshijnë lëshimin e OMGJ në mjedisin natyror duhet t'i referohen BERZH dhe të krahasohen kundrejt kërkesave të zbatueshme të performancës.

¹⁴ CITES: Konventa mbi tregtinë e specieve të rrezikuara të faunës dhe florës të egër. Lista e specieve të rradhura nga CITES është e disponueshme nga IFC ose BERZH. Për të zbuluar se cilat specie janë në listë, ju lutemi vizitoni <http://www.cites.org> ose hyni në bazën e të dhënave për specie CITES në <http://www.cites.org/eng/resources/species.html>

¹⁵ Klientët e angazhuar në gjuetinë e qëndrueshme ekologjike janë të përjashtuara nga ky artikull.

¹⁶ Dokumentet e referencës janë: Rregullorja e (KE) Nr. 1013/2006 e 14 qershorit të vitit 2006 për dërgesat e mbetjeve; Vendimi C(2001)107/Përfundimtar i Këshillit të OECD në lidhje me rishikimin e Vendimit C(92)39/Përfundimtar për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të destinuara për operacionet e rimëkëmbjes; Konventa e Bazelit e 22 marsit të vitit 1989 mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe depozitimit të tyre. Për më shumë informata dhe një udhëzim të thjeshtuar të Konventës të Stambollit, vizitoni <https://www.basel.int>

¹⁷ Sipas Komisionit ndërkombëtar për digat e mëdha (ICOLD), një digë me lartësi prej 15 metrash apo më shumë ose me një vëllim rezervoari më shumë se 3 milion m³ konsiderohet si e madhe.

¹⁸ Substancat që shkatërrojnë ozonin (ODS): komponentat kimike të cilat reagojnë dhe shkatërrojnë ozonin stratosferik, rezultojnë në 'vrimit e ozonit' të njohura gjërësisht. Protokollin i Montrealit rradhit ODS dhe datat e reduktimit dhe përjashtimit të synuar të tyre. Një listë e komponimeve kimike nga Protokollin i Montrealit, që përfshin aerosolet, mjetet ftohëse, agjentët shkumëzues, tretësit dhe agjentët e mbrojtjes nga zjarri, bashkë me detajet e shteteve nënshkruese dhe datat e synuara të përjashtimit, është e disponueshme nga IFC ose BERZH.

¹⁹ Prerjet e paqëndrueshme përfshijnë operacionet e prerjeve komerciale në pyjet parësore, operacionet e prerjes në çdo lloj tjetër të pyjeve që nuk është në pajtim me menaxhimin e certifikuar të qëndrueshëm të pyjeve ose tregtimin e drurit ndryshe nga pyjet e certifikuar të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme.

²⁰ Konventat relevante ndërkombëtare të biodiversitetit përfshijnë, pa kufizim: Konventën për ruajtjen e specieve migruese të kafshëve të egra (Konventa e Bonit); Konventa mbi ligatinat e rëndësishme ndërkombëtare, sidomos si venbanim i shpendëve ujor (Konventa Ramsar); Konventën për ruajtjen e kafshëve të egra evropiane dhe vendbanimeve natyrore (Konventa e Bernës); Konventën e trashëgimisë botërore; Konventën e diversitetit biologjik.

25. Aktivitete që janë brenda, afër, ose në rrjedhën e sipërme të tokës të zënë nga popujt indigjenë dhe/ose grupet e rrezikuara, duke përfshirë tokat dhe rrjedhat ujore të përdorura për aktivitetet e mbijetesës si kullotja e bagëtive, gjuetia ose peshkimi;
26. Aktivitetet të cilat mund të ndikojnë në mënyrë negative në vendet me rëndësi kulturore ose arkeologjike;
27. Aktivitetet të cilat mund të përfshijnë zhvendosjen e pavullnetshme;

Personat juridik të përfshirë në ndonjë nga aktivitetet më poshtë nuk do të financohen²¹:

28. Prodhimi i madh ose tregtimi i pijeve alkoholike (duke përjashtuar birrën dhe verën)²²;
29. Prodhimi i madh ose tregtimi e duhanit²³;
30. Aktivitetet brenda ose afër me zonat e përcaktuara të mbrojtura të klasifikuara sipas Kategorisë IUCN I – IV²⁴;
31. Prodhuesit e artikujve të plastikës për një përdorim apo kokrrizave plastike të përdorura për prodhimin e produkteve, të cilat sipas Direktivës të (BE) 2019/904 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit janë të ndaluara të paraqiten në treg

²¹ Personave juridik të financuar në këtë kategori do u lejohej të kenë llogari dhe të realizojnë transaksione, por nuk janë të pranueshëm për asnjë nga lehtësitë e kredisë bankare.

²² Kjo nuk vlen për personat juridik të cilët nuk janë të përfshirë në mënyrë thelbësore në këto aktivitete si dhe personat juridik me ekspozim të barabartë ose më të vogël se 50,000. EURO "Të papërfshirë në mënyrë thelbësore" do të thotë se aktiviteti në fjalë është ndihmës i operacioneve kryesore të njësisë juridike.

²³ Njësoj si më parë.

²⁴ Nëse një aktivitet do të përkufizohet ose nuk do të përkufizohet si i afërt me një zonë të mbrojtur të klasifikuar nën Kategorinë IUCN I – IV varet nga faktorët e ndryshëm, si qëllimi i ruajtjes të zonës të mbrojtur dhe lloji i aktivitetit. Ndaj afërsia, e cila merret në konsideratë nëse një aktivitet ndodhet brenda rrezes deri në 500 metra nga zona e mbrojtur, analizohet nga rasti në rast.

Aktivitetet në vendbanimet zyrtare njerëzore apo afër zonave të mbrojtura të klasifikuara sipas Kategorive I – IV të IUCN të cilat nuk kanë ndikim domethënës, negativ dhe të pakthyeshëm në mjedisin jetësor dhe që përmirësojnë kushtet mjedisore dhe/ose sociale, siç është dokumentuar në një mendim ekspertit për to, mund të hiqen nga përjashtimi. Sipas përkufizimit të OECD, "vendbanimi njerëzor" përbëhet nga: (a) komponentat fizike të strehimores dhe infrastrukturës; dhe (b) shërbimet për të cilat elementet fizike ofrojnë mbështetje, dmth shërbimet e komunitetit siç janë arsimit, shëndetësia, kultura, mirëqënia, argëtimi dhe ushqimi (burimi: Fjalori i OECD i nocioneve statistikore).

Aktivitetet brenda çdo zone tjetër të mbrojtur siç janë përmendur në mënyrë të veçantë, duhet të vlerësohen nga rasti në rast. Zonat tjera të mbrojtura mund të klasifikohen për shembull në kuadër të Kategorisë IV dhe V të IUCN, Zonat e trashëgimisë botërore natyrore të UNESCO, Zonat Ramsar (Konventa mbi ligatinat e rëndësisë ndërkombëtare), zonat Emerald (Konventa e Bernës), Natura 2000, Zonat kryesore të biodiversitetit.